



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.5.2023

Nr: 514

Ora: 18:00

VENDIM

PËR

LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ZV/KRYETARIT TË KZAZ NR. 15, BASHKIA KURBIN, PËR ZGJEDHJET

PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d” të Kodit Zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë me shkresën nr. 5091 Prot., datë 13.05.2023 ka kërkuar lirim nga detyra të zv/kryetarit z. Mhill Nikoll Luli dhe emërimin e z. Dritan Pal Preçi.

Propozimi dhe kandidatura e paraqitur plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31 dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Lirim nga detyra të zv/kryetarit të KZAZ-së nr.15, z. Mhill Nikoll Luli, Bashkia Kurbin.
2. Emërimin në detyrë të zv/kryetarit të KZAZ-së nr. 15, z. Dritan Pal Preçi, Bashkia Kurbin.

Data: 13.5.2023 Nr: 514
Ora: 18:00



“Për lirim dhe emërimin e zv/kryetarit të KZAZ nr. 15, Bashkia Kurbin, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI